



Planuar / Doretuar Prilbena/Prodato Received/Delivered	05-12-2022	2	viti god Year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHMBHEK	7676/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.871/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.871/2022 të datës 06.10.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat me adresë: Rruga "William Walker" Numër 11, Komuna e Prizrenit, kundër organit të punësimit Komuna e Dragashit, në çështjen juridike "Ndërprerje e Marrëdhënies së Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 05.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Shfuqizohet** Vendimi me numër: 02.111/15-12490/22 i datës 05.09.2022 i Komisionit Disiplinor dhe çështja kthehet në *rishqyrtim* dhe *rivendosje* të organi i njëjtë-Komisioni Disiplinor i Komunës së Dragashit.
- II. Obligohet** Kryetari i Komunës së Dragashit që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, i punësuar në Komunën e Dragashit, me datë 03.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 5938 e cila është pranuar me datë 06.10.2022 dhe regjistruar nën shenjë

A.nr.871/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 02.111/15-15-12490/22 të datës 05.09.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Dragashit, me pretendimin ankimor se i njëjti nuk ka bërë asnjë shkelje të detyrave të punës dhe se vendimi i kontestuar është i kundërligjshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 13.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë e ankuesit të Komuna e Dragashit, ndërsa me datën 21.10.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, sipas kërkesës së anëtarëve të Kolegjit, me datë 21.11.2022 ka nxjerr Vendimin me shifër VK.nr.159/2022, përmes të cilit i ka shtyrë afatin për vendimmarrje edhe për dhjetë (10) ditë pune, ankesës së ankuesit A.nr.871/2022 të datës 06.10.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën me numër te protokollit 5938/2022 të datës 06.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Kosovës; Vendimi për largimin nga shërbimi civil i lëshuar nga Komisioni Disiplinor për Shërbyesit Civil me numër 02.111/15-12490/22 e datës 05.09.2022; Kërkesa për pushim vjetor 2022 për periudhën kohore 27.06.2022 deri 27.07.2022; Kërkesa për pushimin vjetor 2021 për periudhën kohore 07.06.2022 deri 24.06.2022; Përgjigje në kërkesë me numër të referencës 13/520 e datës 26.07.2022; Kërkesë për pushim pa pagesë e datës 15.07.2022; Kërkesë për pushim mjekësor për periudhën kohore 10.05.2022 deri 06.06.2022; Pliko e bardhë e datës 03.10.2022; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 13.10.2022; Përgjigja në ankesë e dërguar përmes E-mailit me numër të protokollit 6299/2022 e datës 19.10.2022; Akt emërimi për ankuesin i datës 05.01.2015; Përshkrimi i detyrave të punës; Raport Mjekësor për ankuesin; E-mail i dërguar nga drejtuar dhe e datës 21.07.2022; E-mail i dërguar nga S.K drejtuar Y.E e datës 27.07.2022; Kërkesa e Drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Dragashit për formimin e Komisionit Disiplinor ndaj me numër 131548 e datës 10.08.2022; E-mail i dërguar nga drejtuar e datës 02.09.2022; Njoftimi për mbajtjen e seancës së parë të Komisionit Disiplinor i datës 25.08.2022; Vendim për caktimin e Komisionit Disiplinor për Shërbyesit Civil në Institucionet e Komunës së Dragashit me numër 112/12-22635/12 i datës 18.08.2022, Autorizimin e datës 05.10.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit te të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar dhe se çështja duhet të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë - Komisioni Disiplinor i Komunës së Dragashit, *sepse*:

Kolegji i Këshillit nga shkresat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 05.01.2015 është i punësuar në pozitën e punës *Zyrtar për Buxhet dhe Financa -2* pranë Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Dragashit.

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë, me datë 10.08.2022 kishte iniciuar procedurës disiplinore ndaj ankuesit për shkak të mungesës në punë, ndërsa Komisioni Disiplinor i Komunës së Dragashit përmes Vendimit me numër 02.111/15-12490/22 të datës

05.09.2022 kishte konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, për shkak të mungesës në punë, dhe si rrjedhojë të njëjtit i ka shqiptuar masën disiplinore *“Largim nga Shërbimi Civil”*.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi fillimisht kishte kërkuar pushim vjetor nga data 27.06.2022 deri me datë 27.07.2022, ndërsa me datë 15.07.2022 i njëjti i është drejtuar Drejtorisë Komunale të Arsimit pranë Komunës së Dragashit me kërkesën që t'i aprovohet pushimi pa pagesë për periudhën kohore nga data 15.07.2022 deri me datë 30.06.2023 me arsyetimin se, citoj: *“kërkesën e arsyetoj ngase gjendem jashtë shtetit për rregullim e dokumentacionit familjar dhe vizitë shëndetësore”*, mirëpo kjo e fundit me datë 26.07.2022 i kishte kthyer përgjigjen me numër efernece:13/520 duke lënë të kuptohet se kërkesa për pushim pa pagesë është bërë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, ngase e njëjta kërkesë nuk është mbuluar me dokumentacionin përkatës dhe se arsyet e kërkesës së datës 15.07.2022 janë kundërthënëse apo nuk ndërlidhen me njëra tjetrën dhe si e tillë kërkesa i është refuzuar.


Kolegji i Këshillit lidhur me këtë çështje ankimore analizoi dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 18 paragrafi 4 dhe 5 ku përcaktohet se: 4. *Pushimet e zyrtarëve publikë rregullohen sipas legjislacionit të punës.* 5. *Kriteret dhe kushtet e orarit të punës dhe të pushimeve përcaktohen nga Qeveria me akt nënligjor, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për punë”,* po ashtu ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, neni 14 paragrafi 2 dhe 3, nën paragrafët 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 ku përcaktohet se: *“Në raste të veçanta zyrtari publik mund të përftojë pushim pa pagesë, për nevoja të: 2.1. ngritjes apo arsimimit më të lartë profesional; 2.2. shëndetit të tij/saj, apo pjesëtarëve të familjes së ngushtë; 2.3. për transferim të përkohshëm në detyra të tjera brenda apo jashtë vendit; 2.4. për kandidim në zgjedhjet komunale apo qendrore.* 3. *Për realizimin e të drejtës për pushim pa pagës sipas paragrafit 1 te këtij neni zyrtari publik duhet te paraqet kërkesën e arsyetuar për pushim pa pagesë. Kërkesa duhet te dorëzohet jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, i cili bashkë me rekomandimin e tij/saj e përcjell për vendimmarrje tek nëpunësi më i lartë civil i institucionit. Vendimi i dorëzohet pa vonesë Zyrtarit dhe Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore”* si dhe neni 40 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës ku përcaktohet se: *“1. Në bazë të kërkesës së të punësuarit, punëdhënësi mund të lejojë që i punësuarit të mungojë nga puna pa kompensim të pagës. 2. Për kohën e mungesës në punë pa kompensim të pagës nga paragrafi 1. i këtij neni, të punësuarit i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtave të cilat burojnë nga pagesa e detyrueshme e kontributeve nga ana e të punësuarit”* dhe rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstatoi se zyrtarëve publikë, në rastin konkretë nëpunësve civil u takon e drejta në pushim pa pagesë, mirëpo vetëm nëse i plotësojnë kushtet e përcaktuara sipas nenit 14 paragrafi 2, nën paragrafët 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të Rregullores Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, dhe vendimi për aprovimi ose jo të kërkesës për pushim pa pagesë merret nga zyrtari kryesor administrativ brenda organit përkatës të punësimit.

Për sa me sipër Kolegji i Këshillit vlerëson se Drejtoria për Arsim e Komunës së Dragashit në përgjigjen e dhënë ankuesit me datë 26.07.2022 ndërlidhur me kërkesën e tij për pushim pa pagesë të datës 15.07.2022, nuk ka pasur parasysh nenin 11 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për

Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "1. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që mosdija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike, që ajo ka sipas ligjit. Organi publik, në veçanti, informon palën për të drejtat dhe detyrimet e saj në procedurën administrative, si dhe për pasojat juridike të veprimeve a mosveprimeve të saj gjatë kësaj procedure. 2. Organi publik, gjatë procedurës administrative, ndihmon që palët të mbrojnë dhe realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre juridike, sa më lehtë të jetë e mundur por pa cenuar të drejtat dhe interesat juridik të personave të tjerë" si dhe nenin 86 paragrafi 1 dhe nenin 97 paragrafi 1 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: "86.1. Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative. 97.1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative", nga rrjedh se Drejtoria e Arsimit e Komunës së Dragashit me rastin e nxjerrjes së përgjigjes së datës 26.07.2022 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase vërehet se ky organ nuk e kanë ndërmarrë asnjë veprim procedurale me qëllim të njoftimit se kërkesa e tij nuk është e mbështetur mjaftueshëm me dokumentacionet e nevojshme, ngase ankuesit ka mundur t'i mungojnë njohurit elementare se kërkesa e tij duhet mbështetet edhe dokumente shtesë me qëllim të aprovimit, andaj mungesa e ndërmarrjes së këtij veprimi nga ana e Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Dragashit, gjegjësisht mos angazhimi i njësisë se burimeve njerëzore ne këtë çështje administrative mund t'i ketë përkeqësuar gjendjen ankuesit lidhur me të drejtën e tij për realizimin e pushimit pa pagesë.

Po ashtu, nga analizimi i Vendimit me numër:02.111/15-12490/22 të datës 05.09.2022 me të cilin ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil", Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të vërtetojë drejtë gjendjen faktike, ngase në asnjë pjesë të arsyetimit të vendimit nuk ka arritur të verifikojë faktin nëse ankuesi e ka pranuar njoftimin e datës 26.07.2022 me shifër 13/520 përmes të cilit është njoftuar se i njëjti është dashur të paraqitet në punë nga data 09.08.2022 në të kundërtën të njëjtit do t'i ndërpritet marrëdhënia e punës, pasi që aktet administrative kundrejt palës fillojnë të prodhojnë efekte juridike vetëm në rastet kur pala njoftohet me përmbajtjen e aktit ashtu siç përcaktohet me nenin 51 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Një akt administrativ fillon të prodhojë pasojat juridike në raport me palën të cilës i drejtohet apo e cila cenohet nga ai, me njoftimin e përmbajtjes të tij", dhe po ashtu nuk është zbatuar drejte ligji material për faktin se aprovimi apo refuzimi i pushimit pa pagesë është në kompetencë të udhëheqësit me të lartë administrative, dhe jo drejtorit të Drejtorisë për Arsim, si staf politik, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi i datës 05.09.2022 me numër:02.111/15-12490/22 përmes të cilit ankuesit i është shqiptuar masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil", është vendim i kundërligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: 1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative, 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; dhe mbi këtë bazë është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, pas administrimit të provave të lëndës dhe rrjedhimisht konstatimeve të dhëna si në arsyetim të këtij vendimi Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet ankimore te ankuesit janë të bazuara dhe se janë plotësuar kushtet ligjore që lënda e ankuesit të kthehet në ri-shqyrtim dhe



rivendosje në mënyrë që organi i shkalles se parë t'i eliminojë vërejtjet e cekura duke marrë parasysh pikëpamjet juridike të dhëna në këtë vendim.


Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1 në paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.871/2022

Flakron GASHI



Procesmbajtës



Jeton KOÇA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të palës ankuese,
- Kryetarit të Komunës së Dragashit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Dragashit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

